

BACHELOR NËGJUHË,LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Bachelor nëGjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.35, datë 07.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë i studimeve
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Greqisht, Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grekë** është të aftësojë studentët në sektorin e arsimit parauniversitar në gjuhën greke, publik dhe privat, si dhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore, në organizata jo fitimprurëse në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në institucione dhe organizata ndërkombëtare etj., që kanë nevojë për njohje të kualifikuar të gjuhës greke. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si mësues për shkollat në gjuhën greke në Minoritetin Etnik Grek dhe në shkolla të tjera që mësohet gjuha greke.
2. Të kenë njohuri dhe të aftësohen si specialistë të lartë edhe në fusha të tjera të gjuhës, letërsisë dhe kulturës greke, si: përkthim dhe interpretim, turizëm, në fushat gjuhësore, letrare e kulturore greke, nëpërshtatje me tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.
3. Të zhvillojnë aftësitë e nevojshme pedagogjike, metodologjike dhe teknologjike për të përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies dhe vlerësimit në mësimin e gjuhës greke.
4. Të jenë në gjendje të analizojnë dhe të vlerësojnë fenomene gjuhësore, letrare dhe kulturore greke, duke përdorur mjete dhe teori shkencore të avancuara.
5. Të aftësohen për të hartuar dhe zbatuar projekte kërkimore dhe arsimore në lidhje me gjuhën, letërsinë dhe kulturën greke, në bashkëpunim me institucione vendase dhe ndërkombëtare.
6. Të përvetësojnë një qëndrim profesional, etik dhe ndërkulturor në ndërveprimet e tyre si mësues apo specialistë të gjuhës greke, duke respektuar dhe promovuar diversitetin kulturor.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit të gjuhës, letërsisë dhe kulturës greke.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin e cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të gjuhës, letërsisë, kulturës, përkthimit, turizmit etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm:**Folklor (ECTS 5),Historia e Greqisë (ECTS 5), Arkeologjia dhe kultura në Epir (ECTS 5), Historia dhe kultura bizantine (ECTS 5), Përkthimi dhe praktika e përkthimit (ECTS 5),Vështrim diakronik i kulturës greke (ECTS 5).

Në total nr i krediteve për këtë kategori 30 ECTS.

2. **Lëndë të formimit karakterizues:**Gjuha e re greke (morfologji – sintaksë) (ECTS 12),Gjuha shqipe (morfologji – sintaksë) (ECTS 8), Letërsia e re greke (shek.XI-XVII) (ECTS 6), Vërrejtje drejshkrimore të gjuhës së re greke (ECTS 6), Letërsi antike greke (ECTS 11), Letërsia e re greke, shek. XVII- XIX (ECTS 12), Hyrje në gjuhësi (ECTS 6), Leksikologji dhe semantikë (ECTS 6), Letërsi e re greke shek. XX (ECTS 6), Vështrim krahasues i letërsisë greko- shqiptare (ECTS 6), Sociolinguistika (ECTS 5).

Në total nr i krediteve për këtë kategori 84 ECTS.

3. **Lëndë integruese:** Greqishtja e vjetër dhe historia e gjuhës greke (ECTS 9), Teoria e letërsisë (ECTS 5), Stilistika e tekstit (ECTS 6)

Në total nr i krediteve për këtë kategori 20 ECTS

4. **Lëndë me zgjedhje:**

Viti I (ECTS 5):Njohuri mbi artet e bukura &muzikë,Teksti dhe analiza e tekstit letrar, Hyrje në PS dhe teknologji të reja

Viti II(ECTS 5):Letërsia e re shqipe, Dialektologji, Mjedisi në lëndët shkollore të arsimit fillor, Struktura tradicionale shoqërore

Viti III(ECTS 5):Letërsi greke, brezi i viteve 30, Onomatologjia, Psikologjia dhe pedagogjia në shkollë, Hartim dhe menaxhim projekti

Në total nr i krediteve për këtë kategori 15 ECTS

5. **Lëndë të formimit plotësues:** Gjuha angleze (ECTS 4), Teknologji të reja në komunikim(ECTS 5), Hyrje në shkencat e edukimit & metodologjia e edukimit (12 ECTS)

Në total nr i krediteve për këtë kategori 21 ECTS

6. **Përgatitje punim diplome: 10 ECTS**

Në total nr i krediteve për këtë kategori 10 ECTS

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në **Gjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek** është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat që i presin në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit **BachelornëGjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek** mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në «Master në arsimin e mesëm të ulët në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek» me 120 ECTS dhe kohëzgjatje dy vite akademike në katër simestra, dhe « Master profesional në mësuesi për arsimin fillor në gjuhën greke» me 60 ECTS me kohëzgjatje një vit akademik në dy semestra, apo në një fushë të ngjajshme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë , në programet :

1. Master në arsimin e mesëm të ulët në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek
2. Master profesional në mësuesi për arsimin fillor në gjuhën greke

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë / mësues të gjuhës greke në fushat e gjuhës, letërsisë dhe kulturës greke, si: përkthim dhe interpretim, turizëm, etj. të kualifikuar me njohuri të tilla sinjohja e gjuhës dhe kulturës greke. Për këtë arsye synimi i programit të studimit **Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek** është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Në shkollat në gjuhën greke në Minoritetin Etnik Grek dhe në shkolla të tjera që mësohet gjuha greke, në sektorin publik dhe privat,
2. Në sektorë të tjerë të veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore,
3. Në organizata jo fitimprurëse në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar,
4. Në institucione dhe organizata ndërkombëtare.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “**Bachelor**” në **Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek** fitojnë njohuri të përparura të gjuhës, por edhe të kulturës, të historisë dhe letërsisë greke.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (*plani mësimor*)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Folklor	5	60	I
2.	Historia e Greqisë	5	52,5	I
3.	Gjuha e re greke (morfoloji – sintaksë)	12	135	I + II
4.	Gjuha shqipe (morfoloji – sintaksë)	8	90	I + II
5.	Letërsia e re greke (shek.XI -XVII)	6	67,5	II
6.	Vërrejtje drejshkrimore të gjuhës së re greke	6	67,5	II
7.	Greqishtja e vjetër dhe historia e gjuhës greke	9	105	II

8.	Me zgjedhje			
	Njohuri mbi artet e bukura& muzikë	5	60	I
	Teksti dhe analiza e tekstit letrar			
	Hyrje në PS dhe teknologji të reja			
9.	Gjuha angleze	4	45	II
Gjithsej viti i parë		60 ECTS		

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Arkeologjia dhe kultura në Epir	5	52,5	II
2.	Historia dhe kultura bizantine	5	52,5	I
3.	Letërsia antike greke	11	120	II
4.	Letërsia e re greke shek.XVII-XIX	12	135	II
5.	Hyrje në gjuhësi	6	67,5	I
6.	Leksikologji dhe semantikë	6	67,5	I
7.Lëndëndërdisiplinore/integruese				
	Teoria e letërsisë	5	60	II
	8.Me zgjedhje			
	Letërsia e re shqipe	5	60	I
	Dialektologji			
	Mjedisi në lëndët shkollore të arsimit fillor			
	Struktura tradicionale shoqërore			
9.	Kategori D. Komponenti mësimor LËNDË			

	PLOTËSUESE			
	Teknologji të reja në komunikim	5 ECTS	60	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS		

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Përkthimi, teoritë dhe praktika e përkthimit	5	60	II
2.	Vështrim diakronik i kulturës greke	5	60	II
3.	Letërsi e re greke shek. XX	6	67,5	I
4.	Vështrim krahasues i letërsisë greko-shqiptare	6	67,5	I
5.	Sociolinguistika	5	60	II
6.	Stilistika e tekstit	6	67,5	I
7. Lëndë me zgjedhje				
	Letërsi greke, brezi i viteve 30.	5	60	I
	Onomatologjia			
	Psikologjia dhe pedagogjia në shkollë			
	Hartim dhe menaxhim projekti			
8.	Kategori D. Komponenti mësimor LËNDË PLOTËSUESE			
	Hyrje në shkencat e edukimit & metodologjia e edukimit	12	135	II
9.	Kategori D. Komponenti mësimor DETYRIME PËRMBYLLËSE			

	Provim formimi / Punim diplome	10 ECTS	75	II
	Gjithsej viti i tretë	60 ECTS		
Total : viti I + viti II + viti III		180 ECTS		-